# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5577
E shtunë, 15 shtator 2018
çmimi 0.40 €


## O'Connelli: Veprimet e këqija të deputetëve duhet të ndëshkohen me votë

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI FAQE 4-5

# Aksioni 'Ta pastrojmë Kosovën' do ta përfshijë edhe veriun

Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se aksioni "Ta pastrojmë Kosovën", i cili do të fillojë sot (e shtunë), do ta përfshijë edhe pjesën e veriut. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se në kuadër të aksionit do të ndodhë edhe pastrimi i pikave kufitare në veri të Kosovës, pika 1 dhe 31. Sipas Matoshit, aksioni ka për qëllim pastrimin e brezave kufitarë, largimin e mbi 1 000 deponive ilegale, pastrimin e brezave rrugorë dhe brezave të lumenjve. Ai ka thënë se deponitë regjionale do t'i pranojnë mbeturinat pa pagesë në periudhën tremujore të pastrimit sa do të zgjasë ky aksion. Matoshi u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve, bashkësive fetare, subjekteve politike, FSK-së, KFOR-it, shoqërisë civile dhe medieve që t'i bashkëngjiten këtij aksioni

MINISTRI PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME TË SHQIPËRISË, DITMIR BUSHATI, KA QËNDRUAR PËR VIZITË ZYRTARE NË KOSOVË

FAQE 3

## Pacolli: Shqipëria ta asistojë Kosovën në të gjitha proceset integruese

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të premten në takimin homologun nga Shqipëria, Ditmir Bushati, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe të diplomacisë. Në kuadër të diskutimeve, ministri Pacolli ka theksuar nevojën për koordinim të veprimeve dhe për përkrahje nga shteti dhe diplomacia shqiptare






## Hoxha: Vendimi i Këshillit të Ministrave, sfida kryesore për heqjen e vizave

FAQE 3

## AKTUALE

### DALJA NGA POLITIKA E QORRSOKAKUT F. 5



Kadri VESELI

### TË GJITHË 'DUAN' ZGJEDHJE, TË GJITHË POROSISIN SONDAZHE DHE TË GJITHË DALIN FITUES! F. 8



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

### TRANZICIONI I FSK-SË ËSHTË SUKSES I PËRBASHKËT! F. 8



Burim RAMADANI

## EKONOMI

### POLICIA U JEP REKOMANDIME BIZNESEVE SE SI TË MBROHEN NGA KRIMET KIBERNETIKE F. 9

### ZEMAJ: MENAXHMENTI I KEDS-it PO INJORON KËRKESAT E PUNËTORËVE F. 9

## KULTURË

### SOT MBAHET FESTIVALI I VALLEVE PËR FËMIJË 'YLBERI I PRISHTINËS' 2018 F. 13

## SPORT

### KRYESUESIT NDAJNË 'MEJDANIN'NË 'ZAHIR PAJAZITI' F. 16

### SOT FILLON HENDBOLLI F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Berisha: Opozita, me Ramën kryeministër, nuk vjen kurrë në pushtet

Prishtinë, 14 shtator - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka thënë se kjo opozitë nuk do të fitojë kurrë sa kohë Edi Rama do të jetë kryeministër. Në studion e emisionit "Opinion" në "TV Klan", Berisha ka akuzuar Ramën se nuk lejon zgjedhje të lira. I pyetur nga gazetarët për mënyrën se si bën Lulzim Basha opozitën, Berisha ka pohuar se pa diskutim që ka bërë opozitë të fortë. "Opozita me Edi Ramën nuk vjen kurrë në pushtet", ka thënë Berisha. Ai u shpreh i bindur se opozita nuk duhet të hyjë në zgjedhje pa rrëzuar fillimisht Edi Ramën nga pushteti, pasi do të dalë e humbur përballë bandave kriminale.



# Rama: Për dialogun Kosovë - Serbi mungon një platformë strategjike kombëtare

Prishtinë, 14 shtator - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është deklaruar për "korrigjimin ose jo të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë". Ai ka thënë se në radhë të parë i takon shtetit dhe autoriteteve të Kosovës të përpunojnë një platformë për dialogun. "Unë jam i fundit njeri që më takon të flas e të bëj komentatorin, ndërsa në Kosovë po bëhet një debat mbi një ide e jo mbi platformë, që ende nuk e kemi parë, ndaj si përfaqësues i Qeverisë së Shqipërisë ndiej thellësisht detyrimin ta respektoj deri në fund Kosovën dhe autoritetet e saj", ka thënë Rama në një intervistë në televizionin "Top Channel".

Ai ka theksuar se kjo është një çështje shumë komplekse dhe se nevojitet një ekip i unitetit kombëtar jo në kuptimin jo fizik e formal, por në kuptimin e qasjes. "Gjithsekush ka detyrën të kontribuojë për këtë çështje, ta përfaqësojë dhe ta mishërojë vullnetin për të qenë një zë i unifikuar dhe jo një klub ku dëgjojmë akuza, ku dëgjojmë të flitet për patriotë e për tradhtarë, për kuzhinierë, argatë e shërbëtorë. Këto nuk çojnë asgjëkundi, sepse çështja është shumë më komplekse", ka deklaruar Rama. Ai ka pohuar se Shqipëria ka detyrimin ta mbështetsë fuqimisht Kosovën, të presë e të ndjekë me shumë vëmendje se çfarë mendojnë përfaqësuesit e saj, dhe për çfarë ata janë në gjendje të bien ose jo dakord. "Ne nuk mund ta bëjmë tutorin e Kosovës. Unë nuk e kam pëlqyer kurrë kur e kanë bërë të tjerët dhe asnjëherë nuk kam marrë përsipër ta bëj vetë. Kjo është një çështje ku luhet fati jo thjesht i Kosovës, po i kombit shqiptar për shumë vite që vijnë. Mund të gabohet shumë lehtë dhe mund të bëhen gabime me pasoja të pakorrigjueshme për shumë e shumë vite më vonë", ka thënë ai.



Sipas tij, të thuash se je për apo kundër korrigjimit të kufijve do të thotë se je për ose kundër një ideje, e cila është shumë pak për të formuluar një qëndrim strategjik kombëtar. "Një ide është shumë pak, është krejtësisht e pamjaftueshme. Mund të jetë një ide për të nisur një dialog të brendshëm në Kosovë mes aktorëve, edhe me ne, nëse duhemi për ta dhënë opinionin tonë, por nuk mund të jetë kurrsesi një paltformë kombëtare dhe, për më tepër, një arsye për t'u ndarë me turravrap, që na ka bërë shpeshherë qesharakë në historinë tonë. Na ka ndodhur shpeshherë t'i faturojmë të ardhmes gabime të rënda të papjekurisë sonë, me ndarjet në tradhtarë e në patriotë", ka deklaruar Rama, duke shtuar se kjo temë është shumë komplekse, me një peshë të jashtëzakonshme, ndaj edhe qasja, sipas tij, duhet të jetë e jashtëzakonshme, jo një qasje banale me aktorë që përpiqen t'i nxjerrin përfitimet e ditës, apo që bëjnë zhurmë të pavetëdijshme se për çfarë po flasin.

# Joseph: Shkëmbimi i territoreve mund të sjellë pasoja serioze në Ballkan




Prishtinë, 14 shtator - Zgjidhja e konfliktit në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes shkëmbimit të territoreve në vija etnike do të kishte pasoja serioze për rajonin. Kështu ka thënë analisti amerikan Edward Joseph.

Në një intervistë për "Zërin e Amerikës" ai ka theksuar se alternativa më e mirë është trajtimi i të drejtave të pakicës serbe në kuadër të kufijve ekzistues që nuk përfshinë krijimin e një republike serbe në Kosovë, të ngjashme me atë në Bosnje. Sipas tij, ndryshimi i qasjes amerikane do të bëjë të mundur për presidentët Thaçi dhe Vuçiqi që të flasin për shkëmbim territoresh në dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli. Analisti i çështjeve të Ballkanit, Edward Joseph, ka paralajmëruar se shkëmbimi i territoreve si një metodë e trajtimit të konflikteve në Ballkan do të kishte pasoja serioze për rajonin.

## Mitchell në Shkup, thirrje votuesve të dalin në referendum

Shkup, 14 shtator - Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Wess Mitchell, gjatë qëndrimit në Shkup u ka bërë thirrje votuesve në Maqedoni të dalin në referendum për, siç ka thënë, të dëgjohet zëri i tyre për të ardhmen e vendit të tyre. Ndërsa kryeministri Zoran Zaev ka shprehur mirënjohje të thella për mbështetjen e vazhdueshme amerikane. Ata të dy i inkurajuan të gjithë drejtuesit politikë, sidomos opozitën, të marrë një qëndrim të qartë lidhur me referendumin e tridhjetë shtatorit.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur konferencë për medie

# Hoxha: Vendimi i Këshillit të Ministrave, sfida kryesore për heqjen e vizave




**Pas votimit të Parlamentit Evropian në favor të rekomandimit për liberalizimin e vizave, Kosova është një hap më afër në procesin e heqjes së vizave. Kështu ka deklaruar të premten ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, në një konferencë për media. Ajo ka bërë me dije se tani sfida kryesore mbetet vendimi i Këshillit të Ministrave por, sipas Hoxhës, nëse ekziston vullneti i shteteve anëtare, deri në fund të vitit qytetarëve të Kosovës do t'u hiqen vizat**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të premten se Kosova ka hyrë në fazën finale të procesit të liberalizimit të vizave. Ajo ka bërë me dije se tani sfidë kryesore mbetet vendimi i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. "Më 17 shtator do të takohet grupi punues për liberalizimin e vizave dhe një javë më pas Kosovën do ta vizitojë grupi i ambasadorëve të BE-së, i cili është mekanizëm në kuadër të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, i cili e merr vendimin final për liberalizim të vizave, do të takohet më 11 dhe 12 tetor, si dhe më 6 dhe 7 dhjetor. Tani jo vetëm se jemi një hap më afër vizave, por jemi në hapin e fundit. Por sfida më e madhe për liberalizimin e vizave do të jetë vendimi në Këshillin e Ministrave sepse në disa prej shteteve anëtare ende po vazhdon debati shumë i ashpër lidhur me çështjen e migrimit", ka deklaruar Hoxha në një konferencë me gazetarë.

Pavarësisht prej hapave të stërzgjatur, ministrja Hoxha ka shprehur optimizëm se nëse ekziston vullneti i shteteve anëtare të BE-së, deri në fund të vitit qytetarëve të Kosovës do t'u hiqen vizat. "Hapat deri në finalen e këtij procesi mund të tingëllojnë si të stërzgjatur, por nëse ka vullnet nga shtetet anëtare, mund të përfundojnë deri në fund të këtij viti", ka theksuar ajo. Sidoqoftë, ministrja Hoxha ka paralajmëruar vazhdimin e procesit të lobimit ani pse vendimi përfundimtar varet nga shtetet anëtare veç e veç. "Deri këtu ku kemi ardhur, kemi pasur përkrahjen e shumë aktorëve. Kemi lobuar dhe do të vazhdojmë të lobojmë. Mirëpo, vendimi përfundimtar do të varet nga shtetet anëtare veç e veç. Disa prej shteteve anëtare që i kanë brengat apo hezitimet e tyre në lidhje me procesin e liberalizimit nuk i kanë për Kosovën, por i kanë për migrimin si çështje më e gjerë që i prek ata në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Ne jemi duke biseduar me këto shtete dhe jemi duke i informuar se Republika e Kosovës i ka forcuar dhe i ka fuqizuar mekanizmat e kontrollit të kufirit, po ashtu i ka forcuar dhe i ka fuqizuar mekanizmat e informimit të qytetarëve, gjithashtu edhe agjencitë ligjzbatuese kanë qenë shumë të suksesshme për luftimin e organizatave kriminale të cilat kanë keqinformuar qytetarët se mund të shkojnë në vendet e BE-së për të kërkuar azil. Prandaj ne këtyre shteteve që kanë hezitime duhet t'u sqarojmë se Kosova nuk paraqet potencial dhe nuk do të jetë sfidë nga një valë e re migrimesh", është shprehur ajo, duke shtuar se për këtë çështje është duke vazhduar fushata vetëdijësuese nga Ministria e Integrimit Evropian dhe nga institucionet e tjera.

Ministrja Hoxha u ka bërë thirrje liderëve shtetërorë, presidentit Hashim Thaçi, kryeparlamentarit Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, që në javët e ardhshme ta shtojnë lobimin te vendet anëtare të Bashkimit Evropian. "Në javët dhe në muajt në vazhdim na mbetet të gjithë neve, duke më përfshirë edhe mua, ministrin e Punëve të Jashtme, kryeministrin, presidentin si dhe kryeparlamentarin, që të gjithë të vazhdojmë të shtojmë fushatën lobuese të komunikimit sa më të drejtpërdrejtë dhe sa më të shpeshtë me shtetet anëtare të BE-së", ka thënë ministrja Hoxha.

Sipas saj, procesi deri në fund do të jetë transparent dhe qytetarët do të njoftohen për të gjitha hapat deri në përmbylljen e këtij procesi të rëndësishëm për vendin. "Është e rëndësishme të përmendet se e vetmja gjë që ne mund të bëjmë tani është fushata vetëdijesuese të cilën veç e kemi filluar. Kjo fushatë ka për qëllim vetëdijesimin dhe informimin e qytetarëve se çka është dhe çka nuk është liberalizimi i vizave në kuptimin e të drejtave dhe obligimeve. Edhe një herë më lejoni të them se ky proces do të kalojë në transparencë të plotë dhe qytetarët do të njoftohen për çdo zhvillim me kohë", ka thënë Hoxha.

Në rast të një vendimi pozitiv për Kosovën, Këshilli i Ministrave duhet ta votojë plotësimndryshimin e rregullores 539/2001. Në rast se votohet pozitivisht, atëherë përcaktohet edhe data se kur do të hyjë në fuqi lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës.

## Kirurgjia e Fëmijëve pajiset me ultrazë të ri



Prishtinë, 14 shtator (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se Kirurgjia e Fëmijëve pas 18 vjetësh është pajisur me ultrazë të ri. Ai ka thënë se tani e tutje fëmijët do të mund t'i marrin të gjitha shërbimet diagnostike në këtë klinikë. "Fotografi që nuk duan shumë fjalë. I pari është ultrazëri i vjetër me të cilin është shërbyer Kirurgjia e Fëmijëve për 18 vjet, ndërsa i dyti ultrazëri i ri që kemi blerë për këtë klinikë. Krahasimin bëjeni ju. Fëmijët tanë tani do të mund t'i marrin të gjitha shërbimet diagnostike në këtë klinikë. Urime të gjithëve!", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Fatmir Matoshi

# Aksioni 'Ta pastrojmë Kosovën' do ta përfshijë edhe veriun



Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se aksioni "Ta pastrojmë Kosovën", i cili do të fillojë sot (e shtunë), do ta përfshijë edhe pjesën e veriut. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se në kuadër të aksionit do të ndodhë edhe pastrimi i pikave kufitare në veri të Kosovës, pika 1 dhe 31. Sipas Matoshit, aksioni ka për qëllim pastrimin e brezave kufitarë, largimin e mbi 1 000 deponive ilegale, pastrimin e brezave rrugorë dhe brezave të lumenjve. Ai ka thënë se deponitë regjionale do t'i pranojnë mbeturinat pa pagesë në periudhën tremujore të pastrimit sa do të zgjasë ky aksion. Matoshi u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve, bashkësive fetare, subjekteve politike, FSK-së, KFOR-it, shoqërisë civile dhe medieve, që t'i bashkëngjiten këtij aksioni




Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" do të realizohet në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ai ka deklaruar se ky aksion do ta përfshijë edhe pastrimin e pjesës veriore të vendit, duke përfshirë pikat kufitare 1 dhe 31. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Matoshi ka thënë se në këtë drejtim do të asistohen edhe nga KFOR-i. "Po, sigurisht, pjesë e pastrimit do të jenë edhe pikat kufitare. Nesër do të kemi aksion pastrimi në pikën kufitare Dheu i Bardhë, për të vazhduar më pas në ditët në vijim edhe në pikat e tjera kufitare. Aksioni për pastrimin e vendit do të shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Një përkrahje në këtë rast do ta kemi edhe nga FSK-ja dhe KFOR-i", ka thënë Matoshi.

Duke treguar për përgatitjet që Qeveria e Kosovës ka bërë për këtë aksion, ushtruesi i detyrës së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka treguar edhe qëllimin e aksionit. "Qëllimi i këtij aksioni është pastrimi i mbeturinave të grumbulluara tash e 19 vjet si dhe vetëdijesimi për ta ruajtur ambientin që na rrethon. Kryesisht me këtë aksion kemi për qëllim pastrimin e brezave kufitarë, largimin e mbi 1 000 deponive ilegale, pastrimin e brezave rrugorë dhe brezave të lumenjve", ka thënë ai, duke ftuar të gjithë qytetarët e Kosovës, institucionet, bashkësitë fetare, subjektet politike, FSK-



në, KFOR-in, shoqërinë civile dhe mediet, që t'i bashkëngjiten aksionit kudo që janë, në lagje, rreth punës dhe shkollave. Më tej, Matoshi ka treguar edhe për vendin se ku do të hedhën mbeturinat e mbledhura. "Me kërkesën e task-forcës për pastrimin e vendit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka marrë vendim që të gjitha deponitë regjionale do t'i pranojnë mbeturinat pa pagesë në periudhën tremujore të pastrimit", ka thënë Matoshi.

**"Epoka e re":** *Z. Matoshi, më 15 shtator nis aksioni "Ta pastrojmë Kosovën". Sa është përgatitur Qeveria dhe ministria që drejtoni për këtë aksion?*

**Matoshi:** Qeveria e Kosovës në mbledhjen e vet të rregullt më 24 korrik 2017 pati themeluar task-forcën nacionale për pastrimin e vendit, i cili aksion ishte caktuar të fillojë nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor 2018. Në këtë task-forcë janë të përfshira të gjitha ministritë përkatëse, ndërsa koordinohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pasi kemi marrë këtë obligim dhe detyrë, kemi themeluar task-forcën teknike e cila, së bashku me shoqërinë civile, ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e këtij aksioni. Po ashtu, janë mobilizuar edhe komunat e Republikës së Kosovës të cilat tashmë, me vendim të obliguar nga MMPH-ja, kanë krijuar task-forcën lokale për pastrimin e komunave të tyre. Paralelisht me këtë aksion MMPH-ja ka lansuar edhe grantin e performancës prej 1.2 milion eurosh për pesë komunat më të suksesshme gjatë këtij aksioni. Gjatë këtyre tre muajve të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të finalizojë udhëzimin administrativ për gjobat mandatore dhe strategjinë nacionale për menaxhimin e mbeturinave, të cilat kanë për qëllim ruajtjen e mjedisit pas përfundimit të këtij aksioni. Gjatë kësaj kohe jemi koordinuar edhe me përfaqësuesit e bashkësive fetare, FSK-në dhe KFOR-in, për t'i bashkërenduar veprimet për aksionin më madhor që ka pasur vendi ynë.

**"Epoka e re":** *Cili është qëllimi i këtij aksioni?*

**Matoshi:** Qëllimi i këtij aksioni nacional është pastrimi i mbeturinave të grumbulluara tash e 19 vjet si dhe vetëdijesimi për ta ruajtur ambientin që na rrethon. Kryesisht me këtë aksioni kemi për qëllim pastrimin e brezave kufitare, largimin e mbi 1 000 deponive ilegale, pastrimin e brezave rrugorë dhe brezave të lumenjve. Andaj, ftoj të gjithë qytetarët e Kosovës, institucionet, bashkësitë fetare, subjektet politike, FSK-në, KFOR-in, shoqërinë civile dhe mediet, që t'i bashkëngjiten aksionit kudo që janë, në lagje, rreth punës dhe shkollave. Angazhimi i të gjithëve për një mjedis të pastër është i rëndësishëm për ne, fëmijët tanë dhe brezat e ardhshëm sepse bëhet fjalë për shëndetin dhe jetët tona.

**"Epoka e re":** *Keni biseduar me shumë institucione për t'iu bashkuar këtij aksioni, po qytetarët sa besoni se do të përgjigjen pozitivisht këtij aksioni?*

**Matoshi:** Duke marrë parasysh mobilizimin e të gjithëve, institucioneve, shoqërisë civile dhe dëshirën e qytetarëve për një Kosovë të pastër, ne jemi të bindur që ky aksion do të jetë më i madhi që nga pas lufta dhe qytetarët do t'i përgjigjen pozitivisht thirrjes sonë për pastrimin e vendit.

**"Epoka e re":** *Është përmendur se ky aksion ka për synim edhe pastrimin e pikave kufitare. Aksioni, a do t'i përfshijë edhe katër komunat e pjesës veriore dhe pikat kufitare 1 dhe 31?*

**Matoshi:** Po, sigurisht, pjesë e pastrimit do të jenë edhe pikat kufitare. Të shtunën do të kemi aksion pastrimi në pikën kufitare "Dheu i Bardhë, për të vazhduar më pas në ditët në vijim edhe në pikat e tjera kufitare. Aksioni për pastrimin e vendit do të shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Përkrahje do të kemi edhe nga FSK-ja dhe KFOR-i.

**"Epoka e re":** *Ku do të deponohen mbeturinat e mbledhura nga aksioni?*

**Matoshi:** Me kërkesën e task-forcës për pastrimin e vendit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka marrë vendim që të gjitha deponitë regjionale do t'i pranojnë mbeturinat pa pagesë në periudhën tremujore të pastrimit.

# Dalja nga politika e qorrsokakut



**Kadri VESELI**

Kuvendi i Kosovës tanimë ka krijuar një traditë shumë të mirë të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë. Kjo ditë merr një rëndësi të veçantë në kontekstin e shoqërive dhe shteteve me demokraci të re, siç është vetë shoqëria e Kosovës.

Demokracia përbën modelin më të mirë të qeverisjes në historinë politike të njerëzimit. Të gjitha modelet e tjera politike që kanë synuar ta zëvendësojnë, kanë dështuar njëra pas tjetrës. Sigurisht do të dështojnë edhe modelet që sot përpiqen të rivalizojnë me demokracinë. Arsyeja pse kjo ka ndodhur dhe do të ndodhë edhe në të ardhmen është shumë e qartë: vetëm demokracia arrin të sigurojë një qeverisje e cila nuk e cenon vlerën më të lartë të individit dhe të shoqërive - lirinë.

Ne besojmë në këtë ide, prandaj kemi zgjedhur të jemi pjesë e botës demokratike, sinonim i së cilës janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Aleanca Veri-Atlantike dhe Bashkimi Evropian.

Nuk kemi asnjë dilemë dhe asnjë hezitim në këtë vizion.

Por, demokracia, para se të jetë ide, është praktikë reale, është mënyrë specifike e qeverisjes dhe mënyrë e jetesës në liri.

Është pikërisht ky dimension që nganjëherë duket se e harrojmë. E kemi gojën plot demokraci, e në anën tjetër lejojmë të na ndodhin gjëra që nuk korrespondojnë me frymën praktike të demokracisë.

Ndërsa e them këtë, fjalën e kam pikërisht te skena jonë politike e cila tash e një kohë të gjatë po ka vështirësi serioze për tejkalimin e polarizimit të dëmshëm partiak.

Në demokraci, dallimet politike janë të ligjshme, por kur ato nuk përfundojnë me konsensus, shndërrohen në rrezik për rendin demokratik. Interesat partiake janë legjitime në demokraci, por ato delegjitimohen sa herë që dalin mbi interesin publik.

I përmenda këto parime, për të dalë te çështja aktuale e dialogut me Serbinë.

Na duhet të ulemi dhe ta gjejmë gjuhën e përbashkët për përballje të sfidave të këtij dialogu. Të ulemi, ashtu siç kemi bërë gjithmonë në të kaluarën dhe kemi pasur sukses. Fryma e përjashtimit reciprok, të cilën aktualisht jemi duke e parë në mjedisin tonë politik, është një rrugë pa krye. Politika e qorrsokakut askujt nuk i shërben dhe të gjithë do të dalim të humbur nëse nuk hiqet dorë prej saj.

Dilemat e ngritura mbi rrezikun për ndarjen e Kosovës nuk janë të qëndrueshme. Realisht, nuk janë dilema tona. Janë gracka të kundërshtarëve të lirisë dhe pavarësisë sonë.

Kosova është shtet i pavarur dhe sovran.

Deklarata e Pavarësisë e 17 Shkurtit është deklaratë e shenjtë për popullin tonë. Prandaj, si e tillë, është e paprekshme. Është e pacenueshme, siç janë gjërat e shenjta.

Kosova ka integritetin e saj territorial, të njohur ndërkombëtarisht.

Ka Kushtetutën e saj demokratike dhe askush nuk ka mandat të marrë vendime që bien ndesh me parimet themelore të saj. Prandaj, duke marrë parasysh këto parime të cilat na bashkojnë, është koha të ulemi dhe së bashku ta trasojmë rrugën përpara. Këtë e presin sot qytetarët nga ne. Ky është obligimi ynë për të cilin kemi marrë mandatin prej tyre.

Një gjë duhet ta kemi të qartë: Ose do ta respektojmë dhe zbatojmë këtë obligim, ose nuk kemi arsye të qëndrojmë në uleset e Kuvendit e të Qeverisë, asnjë ditë të vetme. Rrugë të tretë nuk ka.

**(Ky tekst është fjalimi që kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e ka mbajtur të premten në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë).**

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Kosovë

# Pacolli: Shqipëria ta asistojë Kosovën në të gjitha proceset integruese

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të premten në takimin homologun nga Shqipëria, Ditmir Bushati, me të cilin ka folur për bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë. Në kuadër të diskutimeve ministri Pacolli ka theksuar nevojën për koordinim të veprimeve dhe për përkrahje intensive nga ana e shtetit dhe diplomacisë shqiptare

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të premten homologun e vet, ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati. Me këtë rast, ministri Pacolli ka falënderuar përzemërsisht ministrin Bushati për përkrahjen e vazhdueshme që shteti shqiptar i ka ofruar dhe po i ofron Republikës së Kosovës. Agjenda e takimit mes dy ministrave ka pasur për fokus identifikimin e çështjeve në të cilat mund të thellohet bashkëpunimi dhe propozimi i hapave për adresimin e sfidave të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë.

Në kuadër të diskutimeve, ministri Pacolli ka theksuar se afirmimi i mëtutjeshëm i pozicionit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu dhe objektiva strategjike në lidhje me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, shtron nevojën për koordinim të veprimeve dhe për përkrahje intensive nga ana e shtetit dhe diplomacisë shqiptare.

Ministri Bushati ishte i një mendimi me ministrin Pacolli se çështjet sikurse anëtarësimi në organizata si UNESCO, Interpol, përkrahja e përmbylljes së procesit të liberalizimit të vizave, bashkëpunimi në kuadër të shkëmbimit të përvojave dhe njohurive në lidhje me organizatat rajonale, thellimi i bashkëpunimit në lidhje me shtrirjen e pranisë diplomatike, kërkojnë bashkëpunim dhe koordinim intensiv mes dy vendeve në të gjitha nivelet.

Po gjatë takimit u diskutua rëndësia që Republika e Shqipërisë ka në përkrahje të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse.

Ministri Pacolli edhe në këtë takim bilateral ka theksuar rëndësinë e thellimit të integrimit ekonomik mes dy vendeve, me theks rritjen e volumit tregtar për çfarë është theksuar se është e rëndësishme të lehtësohen barrierat doganore, infrastrukturore dhe teknike.

Në adresimin para mediave, ministrat theksuan se janë pajtuar që çështjet e sipërpërmendura të adresohen në nivel të bashkëpunimit në nivel të profesional e teknik në kuadër të grupeve punuese, në mënyrë që në takimin mes dy qeverive në nëntor 2018 të mund të përmbyllen me sukses.

Ministri Bushati është takuar të premten edhe me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Ndërsa në takimin me zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj u diskutua mbi agjendën e mbledhjes së ardhshme të dy qeverive në Pejë në funksion të konkretizimit të marrëveshje, sidomos në fushën ekonomike. "Unë besoj se parapërgatitjet që i kemi filluar për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët do të rezultojnë me veprime konkrete të cilat do t'i shërbejnë ekonomisë së vendit, lehtësirave ekonomike, thjeshtësimit të procedurave dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve andej e këndej kufirit. Është vullnet i dyanshëm për ta rritur bashkëpunimin në të gjitha fushat, me theks të veçantë në fushën e ekonomisë mes dy vendeve. Edhe ne jemi të përkushtuar të bëjmë hapa konkretë dhe besoj se mbledhja e ardhshme do të mbahet mend për disa vendime të rëndësishme që do të merren përfundimisht dhe bashkëpunimin Tiranë - Prishtinë do ta kthejmë në një nivel krejt tjetër", ka thënë Limaj.

Ministri Bushati është takuar edhe me përfaqësuesit e partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës.




# Aktakuzë ndaj 12 personave për 'veteranët mashtrues'

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar nëpërmjet një komunikate për medie se të premten ka ngritur aktakuzë, të cilën e kanë dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër 12 të pandehurve, për lëndën e njohur në opinion si "Veteranët" në drejtim të veprës penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Në aktakuzë është propozuar që "gjykata ta lëshojë masën për ndalimin e pagesës së pensioneve të fituara në mënyrë të kundërligjshme si veteranë luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në përfundimin e procedurës penale". "Nga provat e siguruara deri më tani është vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të UÇK-së, buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar në shumën prej 68.153.533.14 eurosh", thuhet në komunikatën e Prokurorisë Speciale.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur diskutim publik me temën "Rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve"

# O'Connelli: Veprimet e këqija të deputetëve duhet të ndëshkohen me votë

Ambasadori britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka thënë se qytetarët nuk duhet të pranojnë veprime të këqija të deputetëve, po ata duhet t'i ndëshkojnë me votë. Ai ka thënë se deri tash është protestuar më tepër për tema kombëtare dhe jo për çështje që i prekin çdo ditë qytetarët



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 14 shtator - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar të enjten diskutimin publik me temë "Rritja e transparencës dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve", me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë.
Pjesë e këtij diskutimi me qytetarë ishte ambasadori britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell, si dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës: Vjosa Osmani (LDK), Fitore Pacolli (LVV). Xhevahire Izmaku (PDK), Ahmet Isufi (AAK). Me këtë rast ambasadori britanik Ruairi O'Connell foli për relacionin në mes të qytetarëve dhe të zgjedhurve. "Si duhet qytetarët t'i detyrojnë deputetët të bëjnë atë që qytetarët duan? Qytetarët nuk duhet të pranojnë veprime të këqija të deputetëve. Ata duhet t'i ndëshkojnë me votë. Deputetët reagojnë sipas sjelljeve dhe kërkesave të qytetarëve. Nëse diçka që bëjnë deputetët është e papranueshme, mos e pranoni", ka thënë ai. Sipas O'Connellit, protesta është demokratike por, sipas tij, deri tash është protestuar më tepër për tema kombëtare dhe jo për çështje që i prekin çdo ditë qytetarët. "Nëse nuk reagoni për çështje që ju prekin çdo ditë, atëherë politikanët nuk do të merren me këto çështje", ka thënë ai.
Kurse deputetja Vjosa Osmani ka pohuar se përgjatë këtyre 20 vjetëve qytetaria aktive në raport me politikanët, në rastet kur ka qenë e organizuar mirë, ka qenë jashtëzakonisht e suksesshme. "Andaj ju ftoj të reagoni sa herë që ka nevojë", ka thënë ajo. Sipas Osmanit, demokracia në Kosovë është në udhëkryq sepse në vend se të punohet për demokraci në këta 20 vjet është punuar më shumë në stabilokraci.
Deputetja Xhevahire Izmaku ka thënë se ende ka nevojë për punë për ta rregulluar llogaridhënien karshi zgjedhësve. Ajo ka potencuar se në shumicën e rasteve takohet me qytetarë nga qyteti prej nga ajo vjen përderisa komunikimi virtual ka theksuar se po i mundëson të jetë llogaridhënëse ndaj votuesve në tërë vendin.
Ndërkaq deputetja Fitore Pacolli ka thënë se sot është dita kur duhet të flasim për demokracinë sepse ne si shtet asnjëherë nuk kemi arritur të shkojmë drejt një demokracie të mirëfilltë. Për demokracinë, sipas Pacollit, duhet të diskutohet çdo ditë në mënyrë që të krijohet një qytetari aktive sepse ka thënë se nuk mund të ketë shtet funksional pa një qytetari aktive. Ajo ka shtuar se shteti ka punuar shumë pak që të krijohet një qytetari e tillë. Deputeti Ahmet Isufi ka theksuar se ka papërgjegjësi të deputetëve që nuk po marrin pjesë në seanca dhe po e bëjnë Kuvendin jofunksional. Ai ka vlerësuar se për hir të demokracisë duhet që sot "të bazohemi në interesat e qytetarëve të vendit dhe të reflektojnë të gjitha partitë politike". Isufi ka shtuar se sistemi zgjedhor nuk ua lejon një llogaridhënie të drejtpërdrejtë ndaj votuesve andaj, sipas tij, do të duhej të ndryshonte edhe sistemi zgjedhor. Po ashtu, panelistët i janë përgjigjur interesimit të audiencës për shumë pyetje që lidhen me kuvendin, llogaridhënien dhe transparencën parlamentare.
Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit për rritjen e pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies në Kosovë, i mbështetur nga Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara (UNDEF).

# Në ditën e demokracisë Veseli bën thirrje për unitet të skenës politike



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 14 shtator - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të premten, me rastin e kremtimit të Ditës së Demokracisë, ka thënë se demokracia përbën modelin më të mirë të qeverisjes në historinë politike të njerëzimit ngaqë arrin të sigurojë një qeverisje e cila nuk e cenon vlerën më të lartë të individit dhe të shoqërive, lirinë. "Ne besojmë në këtë ide, prandaj kemi zgjedhur të jemi pjesë e botës demokratike, sinonim i së cilës janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Aleanca Veriatlantike dhe Bashkimi Evropian", ka pohuar Veseli.
Ai ka shtuar se demokracia para se të jetë ide është praktikë reale, është mënyrë specifike e qeverisjes dhe mënyrë e jetesës në liri. "Është pikërisht ky dimension që nganjëherë duket se e harrojmë. E kemi gojën plot demokraci, e në anën tjetër bëjmë gjëra që nuk korrespondojnë më frymën praktike të demokracisë. Ndërsa e them këtë, fjalën e kam pikërisht tek skena jonë politike, e cila tash e një kohë të gjatë po ka vështirësi serioze për tejkalimin e polarizimit të dëmshëm partiak", ka thënë Veseli.
Kreu i Kuvendit ka shtuar se në demokraci dallimet politike janë të ligjshme, por kur ato nuk konkludojnë me konsensus, shndërrohen në rrezik për rendin demokratik. "I përmenda këto parime për të dalë te çështja aktuale e dialogut me Serbinë. Na duhet të ulemi dhe të gjejmë gjuhën e përbashkët në përballje me sfidat e këtij dialogu", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli, duke shtuar se fryma e përjashtimit reciprok është një rrugë pa krye. "Dilemat e ngritura mbi rrezikun për ndarjen e Kosovës nuk janë të qëndrueshme. Nuk janë dilema tona, realisht. Janë gracka të kundërshtarëve të lirisë dhe pavarësisë sonë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit është deklaratë e shenjtë për popullin tonë. Prandaj, si e tillë, është e paprekshme. Kosova ka integritetin e vet territorial, të njohur ndërkombëtarisht. Ka kushtetutën e saj dhe askush nuk ka mandat të marrë vendime që bien ndesh me parimet themelore të saj", është shprehur Veseli. Në kremtimin e ditës së demokracisë, kryeparlamentari Veseli ka takuar nxënës të shkollave të ndryshme të Kosovës që vizituan Kuvendin e Kosovës.

# Të gjithë 'duan' zgjedhje, të gjithë porosisin sondazhe dhe të gjithë dalin fitues!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Menjëherë pasi u formua koalicioni që e mundësoi krijimin e qeverisë Haradinaj, nga opozita dolën zëra se duhet të shkohet në zgjedhje të reja pas së cilës do ta kishim një qeveri dhe qeverisje demokratike. Realisht, në vendet apo shtetet ku demokracia është ende në pampersa, opozita e përdorë këtë armë për të ardhur në pushtet me një rrugë të shkurtër duke kaluar nëpër disa shtigje të cilat, megjithatë, nuk iu garantojnë kyçje të sigurt në autoudhën ku do ta lëshonin në lerë dhe do t'ia krisnin gjumit për të cilën akuzohet pozita. Në ndërkohë, në Kosovë ndodhën disa zhvillime gjysmë dramatike, gjysmëkomike, dramatike dhe skajshmërisht komike që e ndryshuan gjeografinë e votave dhe anatominë elektorale. Koalicioni qeverisës apo koalicioni i pakicës shqiptare e formuan një qeveri që analistët kujdestarë dhe të gjithëdijshëm e vlerësuan klinikisht të vdekur dhe që mbahej në jetë në sallën e reanimacionit të ambasadave të huaja të cilat shihnin interes te kjo garniturë qeverisëse se do t'ua realizonin disa projekte të cilat nuk i realizoi as koalicioni i madh (PDK me LDK) + Lista Serbe dhe 6+. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi ishte pragu ku morën në thua koalicioni i madh dhe kjo shërbeu si pretekst që të rrëzohet qeveria Mustafa. LDK-ja, si parti klienteliste e që ka shkuar në shtrat me të gjithë hamshorët që e kanë marrë në qeveri, nuk pati guxim ta hedhë në votim Demarkacionin me Malin e Zi, prandaj ra qeveria Mustafa, në ndërkohë që LDK-ja e mundësoi votimin për kalimin e demarkacionit gjatë qeverisjes Haradinaj. Merreni me mend këtë shkurtëpamësi politike, ne vend se ta hidhnin në votim sa ishin në qeveri, u detyruan ta votojnë kur ishin në opozitë! Po kjo LDK e ndihmoi Hashim Thaçin t'i marrë votat e nevojshme për president të Kosovës, madje ato vota ishin përcaktuese për fotelen presidenciale të presidentit tonë legjendar. Të pafytyrë janë disa personazhe kalimtare të politikës kosovare, në njërën anë e quajnë Hashim Thaçin kriminel dhe e denoncojnë te gjitha gjykatat kombëtare dhe ndërkombëtare duke ia bartur çantat Dik Martit, kurse në anën tjetër ia japin votën për president ose ia sigurojnë kuorumin e nevojshëm për t'u zgjedhur president. LDK-ja e pati një fat të keq që lideri i saj pati probleme shëndetësore (disa "kryetarë" në pritje në LDK këtë e konsiderojnë fat të mirë dhe mundësi të bëhen Isa Mustafa të rinj) prandaj, LDK-ja në vend se të merret me konsolidimin e partisë dhe përgatitje për zgjedhje të reja, iku në ekstrem duke përdorur fjalor shumë të dhunshëm që nuk e ka karakterizuar këtë subjekt politik më parë. Në këtë rebelim dhe promovim të fjalorit të dhunshëm të LDK-së, flamurin e mori një profesor apo teknopolitikan i cili nuk lidhje me dhunën dhe dhuna nuk i shkon, as për kah pamja e lërë më për kah përmbajtja. Ky ishte Abdullah Hoti apo siç kanë filluar ta quajnë me shpoti, Komandant Dulla. Edhe Driton Selmanaj i katapultuar nga e ashtuquajtura shoqëri civile, në vend se të punojë në reformimin e partisë duke krijuar hapësirë për kuadro të reja si zëvendësim të elefantëve të LDK-së që e kanë gllabëruar hapësirën brenda këtij subjekti politik përmes klientelizmit komunal dhe parave nga tenderët dhe abuzimet tjera u bë krah i djathë i Avdullah Hotit me pretendime që ta lërë Komandant Dullën fare pa krahë. Përfundimisht, LDK-ja sot është parti ku, më shumë ka kandidatë për kryetar të partisë se që ka anëtarë.

Partia Demokratike e Kosovës, jo që mori një goditje të pritur nga elektorati por e mori atë që e ka merituar. Hashim Thaçi u dorëheq nga të qenit anëtar i PDK-së pasi u bë president, në njërën anë kurse realisht ai vetëm sa e forcoi postin e kryetarit të PDK, tash nga pozita e presidentit. Ai e ka promovuar dhe po e forcon biseksualitetin në politikë, në njërën anë është president legal kurse në anën tjetër është kryetar i PDK-së, si ilegal. Kadri Veseli pati probleme të transformimit, nga një udhëheqës i shërbimit informativ, në një udhëheqës politik me pretendime ta ketë rolin e një lideri që do të bënte reforma aq të domosdoshme për PDK-në. Deri më tani është në gjysmë të rrugës ku laura e përparimit definitiv apo pengimit, siç edhe po ndodhë e mbanë emrin dhe firmën e Hashim Thaçit. Dihet mirëfilli se disa deputetë dhe ministra e që kanë qenë si thua në mishin e gishtërinjve të Hashim Thaçit fillimisht e kanë bojkotuar Kadri Veselin kurse më vonë janë heshtur duke pritur çastin t'i vendosin lakun në fyt. Këta sabotues po e luajnë rolin që e luan Lista Serbe në Kuvendin dhe qeverinë Haradinaj, kur kanë interes janë konstruktiv kurse kur nuk kanë interes janë destruktiv. Kështu janë "njerëzit e Hashimit" në shtëpinë e quajtur PDK ku qiraxhi është Kadri Veseli. Kur krejt kësaj i shtohen këshilltarët "gjenialë" që i ka pasur dhe i ka (disa prej tyre e që janë shumicë) Kadri Veseli atëherë Kadriu nuk i ka punët edhe aq keq.

LV-ja ka shpërthyer në zgjedhjet e fundit dhe u rritë aq shumë saqë lëkura e LV-së nuk kishte mundësi t'i mbajë brenda. Gufuan aq shumë sikur qumështi kur vlon shumë dhe pastaj, në mungesë të kujdesit derdhet jashtë enës së vlimit. LV-ja tërë kohën merrej me ndarjen dhe çarjen e subjekteve tjera në ndërkohë që edhe vet u nda dhe nuk ka ndodhur deri më tani që një subjekt politik të ndahet aq keq saqë u përdorën fjalë dhe cilësime aq të rënda që nuk janë përdorur as në kohën e luftës së ftohtë apo në krizën kubaneze të quajtur Gjiri i Derrave. Njëri krah u bë PSD-ja e Kaçusha Jasharit e cila ua lëshoi partinë me qira kurse tjetri mbeti besnik i Albin Kurtit. Kjo ndarje edhe sot po ndikon në skenën politike kosovare sikur që do të jetë përcaktuese për zgjedhjet e ardhshme, kurdo që ato të mbahen. Nisma dhe AAK-ja arritën rezultate më të mira se që kanë pritur kurse pakicat, falë koçeve të Ahtisarit asnjëherë nuk mbeten pa mish.

**Sondazhet për zgjedhje:** LDK-ja dhe LV-ja po insistojnë që zgjedhjet të mbahen sa më shpejt duke shpresuar se bindshëm do t'i fitojnë këto zgjedhje. Edhe sondazhet por edhe unë mendoj se LDK-ja mund të jetë fituese e zgjedhjeve, me një rezultat të ngushtë. Për shkak të çarjes dhe ndarjes së LV-së, PDK-ja ndonëse është në komë politike mund të shpresojë të dalë subjekti i dytë kurse LV-ja do të jetë e treta, ose edhe e dyta. Mendoj se AAK-ja, nëse zgjedhjet mbahen në gjashtë muajt e ardhshëm do të ketë rritje kurse edhe Nisma do e kalojë pragun. Edhe PSD-ja e kalon pragun kurse AKR-ja dhe Alternativa, si Romeo e Gjulieta do të varrosen politikisht për t'u mos ringjallur kurrë më.

Po të lidhnin një koalicion parazgjedhor LDK + LV dhe Nisma mund të fitojnë 42-45 për qind të votave por se është vështirë të ndodhë sepse nuk mund të bëhen kryeministra në të njëjtën kohë Albin Kurti dhe Komandant Dulla. Për PDK-në do të ishte më së mirë të kalojë në opozitë ndryshe do të duhej të pranojë kushte poshtëruese për të qëndruar në pushtet. Edhe pas zgjedhjeve eventuale , nuk do të kishim ndryshime të mëdha dhe partitë e vogla do ta vendosnin se kush do ta formojë qeverinë. Partitë e vogla me numra do të shndërroheshin në fuqi të madhe politike për shkak të kapacitetit shantazhues që do e kishin.

Njëherë nuk shohë se do të ketë zgjedhje. Pozita nuk është e interesuar për zgjedhje të reja kurse opozita, më shumë po shtiret se që ka qëllim të shkojë në zgjedhje por edhe në këtë rast nuk i ka numrat që të provokojë zgjedhje të reja. Zgjedhje të reja mund të ketë vetëm nëse për këtë e dhënë pëlqimin dy kryetarët e PDK-së, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ose nëse rrezikohet seriozisht e tashmja politike e Hashim Thaçit i cili, në këtë rast e shpërndanë Kuvendin (edhe ashtu gjysmë të shpërndarë) duke e bërë rrush dhe kumbulla apo lesh e li. Vetëm në këto situata mund të ketë zgjedhje të reja. Sa u përket sondazheve që i ka bërë KDI-ja, është çështje interpretimi dhe interesi. Unë ndoshta do të pajtohesha me renditjen por jo edhe me përqindjen e votave. Pastaj, kriteret që janë përdorur gjatë intervistimit i bëjnë rezultatet, më shumë të pabesueshme, sesa të besueshme. Nuk është sot fare problem të dilni fitues në zgjedhje, i keni 4-5000 euro, e gjeni një OJQ të "specializuar" për zgjedhje apo kompani dhe lehtësisht do të dilni fitues.

Kohëve të fundit edhe unë e bëra një sondazh për postin e presidentit të Kosovës. Si kritere të intervistimit mora përvojën politike, inteligjencën, përgatitjen shkollore, oratorinë, pamjen fizike, integritetin moral dhe profesional, të kaluarën e lavdishme, pikëpamjet për të ardhmen, rezultatet në luftimin e dukurive negative (korrupsionin, krimin e organizuar, trafikimin me qenie njerëzore dhe poste politike, nepotizmin etj.), pranueshmërinë e publikut dhe performancën para medieve sikur edhe elegancën e përgjithshme dhe rezultatet, për ju mund të paraqesin befasi, por për mua ishin të pritshme; për president të Kosovës, sipas sondazhit tim bindshëm do të fitonte me 78,89 për qind të votave, z. Zafir Berisha kurse për zëvendëspresident gjithashtu bindshëm do të fitonin Duda Balje me 99.99 për qind të votave dhe Danush Ademi me 97.77 për qind të votave. Rezultatet e këtij sondazhi në vendin e parafundit e shohin kandidatin permanent për president të Kosovës, Sermeb Gjergjin kurse presidenti aktual Hashim Thaçi prinë bindshëm si i fundit në listën e garuesve. Këto ishin rezultatet e sondazhit tim, u pajtuat apo nuk u pajtuat me to.

# Policia u jep rekomandime bizneseve se si të mbrohen nga krimet kibernetike



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Policia e Kosovës ka dhënë disa rekomandime për bizneset në mënyrë që ato të mbrohen nga krimet kibernetike për të cilat thotë të ketë pranuar një numër të madh të rasteve të raportuara. "Kohët e fundit janë duke u raportuar raste nga pronarët e kompanive të bizneseve të ndryshme që kanë të bëjnë me një formë mashtrimi përmes sistemeve kompjuterike, ku si pasojë shkaktohet dëm i konsiderueshëm. Personat e dyshuar arrijnë në forma të ndryshme të sigurojnë të dhëna për kompanitë e biznesit siç janë: qarkullimin e mallrave, faturat, pagesat e ndryshme, komunikimet përmes kompjuterit (e-maileve) etj", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Sipas policisë, këto të dhëna i përpunojnë apo i falsifikojnë në atë mënyrë që të jenë të besueshme, pastaj fillojnë me mashtrim. "Bazuar në rastet e deritanishme, personat e dyshuar kanë arritur të ndërhyjnë në komunikimin përmes internetit (shkëmbimin e e-maileve) të kompanive biznesore (njëra në Kosovë e tjetra jashtë Kosovës), duke ndryshuar të dhënat e xhirollogarive si dhe duke u paraqitur në emër të kompanisë tek e cila është dashur të transferohen mjetet për pagesë të mallit. Fatkeqësisht, në disa raste transferimet janë realizuar dhe mjetet janë tërhequr jashtë Kosovës, por në disa raste ato janë stopuar dhe mjetet janë bllokuar gjithashtu në bankat jashtë Kosovës, pasi është arritur të raportohet shpejt mashtrimi", është bërë me dije në komunikatën e Policisë së Kosovës, duke shtuar se hetimi dhe identifikimi i kryeseve të këtyre veprave nuk është i lehtë, pasi më komplekse situatën e bën edhe natyra e rasteve ku pothuajse të gjitha janë ndërkombëtare.

Policia e Kosovës e ka parë të nevojshme të nxjerrë disa rekomandime për kompanitë e bizneseve me qëllim që të mos bien pre e këtyre mashtrimeve. Sipas këtyre rekomandimeve, bizneset duhet t'i sigurojnë sistemet kompjuterike me antivirus; të përdorin vetëm një kompjuter për komunikim si dhe kjo të bëhet në formë të kontrolluar, p. sh., të autorizohet vetëm një apo dy punonjës të kompanisë që merren me komunikim dhe transaksione; në këtë kompjuter mos të instalohen kurrfarë programesh përpos atyre që janë të nevojshme për kryerjen e punëve dhe për të cilat ka licencë, të mos hapen e-maile të dyshimtë apo që nuk iu dihet dërguesi, para autorizimit të kryerjes së transaksionit të konfirmohet me kompaninë partnere nëse xhirollogaria është e vërtetë, kjo mund të bëhet përmes komunikimit në forma të tjera (p. sh., me telefon fiks), për çdo transaksion t'i kontaktojnë bankat respektive në Kosovë, gjithashtu edhe në këtë mënyrë mund të dihet se ku gjendet xhirollogaria.

# Kryetari i OEK-ut viziton Komunën e Vushtrrisë dhe kompanitë vendore



PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët, ishte për vizitë në kompanitë "Ciao Berto", "Binni", "Emona", "Albed" dhe, së fundmi, është takuar edhe me kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri.

Gjatë kësaj vizite kryetari Rukiqi u shpreh i kënaqur me potencialin e sektorit privat, njëkohësisht u bisedua për barrierat kryesore me të cilat ballafaqohen kompanitë në Kosovë. Disa prej problemeve që u potencuan më së shumti janë problemi i furnizimit me energjinë elektrike, përqindja e lartë e informalitetit dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Kryetari Rukiqi ka theksuar se Oda Ekonomike e Kosovës është gjithmonë e gatshme në përkrahje të prodhuesve vendorë për lehtësimin e këtyre problemeve dhe krijimin e mundësive të reja për shtrirjen e eksportit të bizneseve kosovare në tregjet ndërkombëtare. Po ashtu, gjatë vizitave kryetari Rukiqi ka shtuar se sektori privat paraqet rolin kryesor për rritjen e punësimit dhe përmirësimin e imazhit të Kosovës.

# Zemaj: Menaxhmenti i KEDS-it po injoron kërkesat e punëtorëve

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se menaxhementi i KEDS-it është duke injoruar kërkesat e punëtorëve të cilët në vazhdimësi kanë kërkuar tretman të dinjitetshëm në bazë të punës dhe aktivitetit të cilin e bëjnë me mund dhe sakrificë jo tani, por edhe në të kaluarën. "Punëtorët detyrohen të protestojnë për kërkesat e tyre të cilat janë të garantuara me ligj dhe kontratën kolektive, por KEDS-i mban qëndrimin inferior duke konsideruar menaxhimin si diçka të cilën e kanë fituar dhe mund ta përdorin fuqinë punëtore sikurse të ishin njerëz të dorës së dytë dhe duke iu mohuar të drejtat e tyre të trajtimit me dinjitet. Kjo është pasojë nga privatizimi i keq, për interesa grupore, ku sot e kësaj dite nuk ka sjellë të mira për Kosovën dhe punëtorët të cilët kanë shkrirë mund për ta mbajtur gjallë këtë aset të rëndësishëm ekonomik të Kosovës", ka shkruar Zemaj. Ai ka kërkuar që kjo praktikë të ndërpritet dhe që punëtorët t'i gëzojnë të drejtat e tyre legjitime, njëhësh të ndalen praktikat diskriminuese të KEDS-it në të gjitha aspektet. "Personalisht e përkrah zërin e arsyes së protestës së këtyre punëtorëve dhe urgjentisht Qeveria duhet të ndërhyrë në zgjidhjen e këtyre kërkesave legjitime dhe kuptimplota", ka thënë Zemaj.



# Prokuroria e Ferizajt, e hapur për qytetarët

FERIZAJ, 14 SHTATOR (ER)- Prokuroria Themelore në Ferizaj po vazhdon të mbajë takime të hapura me qytetarë, çdo të premte prej orës 10:00-12:00, të cilët po shprehin interesim që të takohen dhe të bisedojnë me kryeprokurorin e kësaj prokurorie, Shukri Jashari.
Kryeprokurori Jashari ka biseduar për çështje dhe kërkesa të ndryshme me palët e interesuara duke u dhënë atyre sqarimet e duhura dhe duke ofruar mbështetjen e Prokurorisë që ai udhëheq. Prokuroria Themelore në Ferizaj do të vazhdojë të mbajë komunikim dhe bashkëpunim me publikun me qëllim të transparencës së punës të kësaj prokurorie.



# Premtohet bashkëpunim më i madh mes institucioneve të sigurisë

GJILAN, 14 SHTATOR (ER)- Drejtuesit e Gjykatës Themelore të Gjilanit, Prokurorisë Themelore dhe Drejtorisë së Stacionit Rajonal në Gjilan, kanë mbajtur një takim të premten, për mundësinë e rritjes së bashkëpunimit dhe eliminimin e barrierave mes këtyre institucioneve.
Kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit, Ramiz Azizi fillimisht ka falënderuar drejtuesit e Prokurorisë dhe komandantët e gjitha stacioneve policore në regjionin e Gjilanit për bashkëpunimin e deritashëm.
I pari i Gjykatës ka kërkuar që ky bashkëpunim të rritet edhe më shumë, në mënyrë që qytetari të ndihet i sigurt në këtë regjion, me theks të veçantë ka përmendur dukurinë e dhunës në familje, duke shtuar se kjo çështje është marr seriozisht dhe është caktuar një gjyqtar për trajtimin e këtyre lëndëve.
Nga ana tjetër kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Gjilanit, Jetish Maloku, i cili ka qenë edhe nikoqir i këtij takimi, ka thënë se edhe institucioni që ai drejton ka ndërmarr hapat në këtë drejtim, duke caktuar dy prokurorë për rastet e dhunës në familje.
Ndërkohë, komandanti i Njësisë së Hetimeve në Stacionin Policor në Gjilan, Remzi Azemi ka përmendur si dukuri shqetësuese përdorimin e substancave narkotike tek të rinjtë, si dhe veprën penale të "grabitjes", që kohët e fundit janë rritur dukshëm rastet e tilla.
Dakordim i të gjithëve ishte që me një koordinim më të mirë mes institucioneve rezultatet do të jenë edhe më të mira në fushën e sigurisë.






# Në Prizren arrestohen katër persona për armëmbajtje pa leje

PRIZREN, 14 SHTATOR- Policia e Kosovës ka njoftuar se në qytetin e Prizrenit janë arrestuar katër persona pasi në veturën e tyre, gjatë kontrollimit nga ana e policisë, janë gjetur dhe konfiskuar një revole me dy karikatorë dhe 22 copë fishekë. "Një nga të dyshuarit ka dalë prej automjetit për t'iu shmangur arrestimit dhe gjatë ikjes ka sulmuar një zyrtar policor i cili ka pësuar lëndime trupore. Me vendim të prokurorit tre të dyshuar dërgohen në mbajtje, kurse i dyshuari i katërt ka rezultuar të ketë urdhëresa lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë", është theksuar në njoftimin e policisë.



# 4 500 pacientë brenda ditës në QKMF në Prishtinë

PRISHTINË, 14 SHTATOR (ER) - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë në ditë kryejnë vizita 4 500 pacientë. Kështu ka bërë me dije drejtori i Shëndetësisë për Komunën e Prishtinës, Arben Vitia, duke iu referuar raportit gjashtëmujor. Ai ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se ka pasur rritje të përqindjes së shërbimeve në këtë qendër. "Rritje e numrit të vizitave dhe shërbimeve mbi 10 për qind. Vetëm shërbimet në laborator 10.3 për qind më shumë. Mesatarja e pacienteve në ditë rreth 4 500. Referimi në institucione të tjera 15 për qind. Mbi të gjitha, edukim, promovim dhe punë e vazhdueshme vullnetare", ka shkruar Vitia. Ai për këtë gjë ka përgëzuar stafin e këtij institucioni.

# Faktorët gjeopolitikë dhe gjeostrategjikë në Ballkan



Garip SAHITI

Ballkani (ose Gadishulli i Ballkanit) është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës Juglindore. Rajoni ka një zonë të përbashkët prej 550.000 km² dhe një popullsi prej rreth 55 milionë banorësh. Në Ballkan nuk ka asnjë shtet që do të paraqiste ambicie dhe njëkohësisht t'i ketë kushtet faktike për t'u realizuar si faktor i rëndësishëm strategjik, qoftë në atë hapësirë, qoftë më gjerë. Njohës të rrethanave ndërkombëtare si protagonistë realë shihnin Kroacinë dhe Serbinë, por këto mbetën vetëm deklarata ambicioze. Sikur të mos e shprehte ambicien e saj serbomadhe, që ka çuar në luftëra në Ballkan, në humbje dhe thyerje të saj, Serbia do të mund ta luante një rol të rëndësishëm në rajon.

Pozicioni i saj qendror, madhësia, pozita, roli i dikurshëm i Beogradit si qendër ndërkombëtare, lidhjet e vjetra tradicionale me Moskën, Parisin, Londrën, pastaj me serbët në Kroaci, në Kosovë dhe në Bosnjë, pra të gjitha këto krahas një politike të jashtme të kaluar dhe të tanishme do të mundësonin të bëhej një faktor i rëndësishëm në Bosnjë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Kosovë, pra në një hapësirë mjaft të gjerë ballkanike. Serbia e ka humbur këtë mundësi me politikën e jashtme që nuk e ka marrë parasysh realitetin e mjedisit ndërkombëtarë.

Bullgaria dhe Rumania nuk kanë kushte dhe nuk tregojnë ambicie për rol më të madh në rajon. Anëtarësimi i tyre në BE dhe në NATO i ka ndërthurur në interesat politike dhe ekonomike të bashkimit. Ambicia e tyre e parë është zhvillohen në mjedisin evropian, pra t'i shfrytëzojnë mundësitë që u ofron BE-ja. Bullgaria, përndryshe provon në mënyrën e saj tradicionale të ketë rol të rëndësishëm në Maqedoni.

Greqia në vitet e para pas rënies së Murit të Berlinit ka treguar ambicie më të mëdha në rajon, në veçanti në Maqedoni dhe në Shqipëri, por edhe në Bullgari e në Serbi. Mirëpo, tani ajo është ekonomikisht tepër e dobët dhe me marrëdhënie të koklavitura me Maqedoninë, e edhe me Shqipërinë dhe Kosovën, e në veçanti me Turqinë. Ajo nuk ka kushte të bëhet faktorë strategjik në rajon. Turqia të cilën mund ta konsiderojmë si shtet ballkanik, i ka disa dispozita që do t'i mundësonin rol të rëndësishëm, para së gjithash në ato shtete të rajonit me popullatë të shumtë myslimane. Rëndësi strategjike në rajon, Turqisë i jep madhësia e saj, numri i popullsisë, ekonomia me rritje të shpejtë, fuqia ushtarake, pozita e urës ndërmjet Azisë dhe Evropës dhe pranë Detit të Zi, që po bëhet gjithnjë më e rëndësishme jo vetëm për lundrim por edhe për edhe për furnizim të ardhshëm energjetik të Evropës. Turqia që ka paraqitur interesat e veta në Ballkan në vitet e shkatërrimit të Jugosllavisë, në veçanti atje ku është popullsia e shumtë myslimane, si në Bosnje, Kosovë, por edhe në Maqedoni, Shqipëri e Bullgari.

BeH, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova nuk janë të afta të luajnë rol më të rëndësishëm në rajon. Ato ballafaqohen me problemet e zhvillimit të vet dhe të mbijetesës, si dhe me antagonizma të shumta të politikës së brendshme, me çështjen e kombësive dhe pakicave fetare, me ekonomi të pazhvilluar, me siguri të dobët juridike, me korrupsion, etj.

Në hapësirën e Evropës Juglindore nuk ka shtet që do të mund ta quanim si faktor strategjik apo si shtet fuqi me përjashtim të, ndoshta, Turqisë. Mirëpo, në këtë rajon me interesa dhe ambicie të veta dhe me politikën e jashtme ndërhyjnë qoftë fuqitë e mëdha, "lojtarët gjeostrategjikë", por edhe shtetet nga fqinjësia. Në mesin e shteteve nga fqinjësia në rend të parë duhet përmendur Italinë.

Italisë në aspektin gjeostrategjik i ka konvenuar fuqimisht shkatërrimi i Jugosllavisë. Me politikën e vet aktive në hapësirën në lindje të detit Adriatik, në Ballkan, Italia tenton të shfrytëzojë fuqinë e vet ekonomike dhe të vërtetohet edhe si aktor politik ndërkombëtar i rendit të parë. Politika e jashtme e Italisë për këtë arsye është dhe do të jetë e rëndësishme në veçanti për faktin se lojtarët tjerë gjeostrategjikë po i kushtojnë Ballkanit kujdes gjithnjë e më të vogël.

Edhe për Austrinë ka qenë interes i madh shkatërrimi i Jugosllavisë. Pas rënies së Murit të Berlinit dhe pas shkatërrimit të Jugosllavisë, Austria e ka shfrytëzuar mjaft mirë pozitën e vet politike dhe ekonomike si dhe lidhshmërinë tradicionale me Evropën Qendrore dhe Juglindore. Ajo ka pasur sukses të shtrihet në një numër të madh të shteteve të këtij rajoni si njëri ndër partnerët dhe investuesit më të rëndësishëm ekonomik, në veçanti ndaj shteteve me fuqi të dobët ekonomike e politike.

Treshja e madhe brenda BE-së, Gjermania, Franca dhe Anglia kanë interesa ekonomike në këtë hapësirë. Pozita e këtij rajoni të Evropës është e rëndësishme për furnizimin me energji, për rregullimin e naftë përçuesve dhe gaz përçuesve, ndaj mund ta rris interesimin e tyre për Ballkanin. Gjermania është tërhequr nga kjo hapësirë pas vitit 1992 dhe e ka drejtuar kujdesin e vet drejt Evropës Lindore. Në hapësirën e Ballkanit e lidhin disa lidhje tradicionale me Serbinë, Kroacinë dhe Sllloveninë.

SHBA-të në Evropën Juglindore, gjegjësisht në Ballkan, nuk kanë interesa të mëdha, pasi që kanë pasur sukses në zgjerimin e NATO-s si dhe t'i inkuadrojnë në të edhe Kroacinë dhe Shqipërinë. Interesat më stabile ekonomike, politike të sigurisë të SHBA-ve janë orientuar para së gjithash në Lindjen e Afërme, në Azinë Qendrore dhe së fundi edhe në Afrikë. Rëndësia e Ballkanit për SHBA-në para së gjithash paraqitet aty që destabilizimi në këtë hapësirë mos të kërkojë angazhim amerikan apo ndërhyrje të NATO-s, apo që të mos çojë në mospajtim dhe në ndërlikime të marrëdhënieve me Rusinë. Angazhimi amerikan për rregullimin e shpejtë të statusit të Kosovës dhe pranimi i pavarësisë së saj duhet kuptuar si tentativë për ta parandaluar që çështja kosovare të mos eskalojë përsëri në konflikt, që do të kërkonte edhe angazhim amerikan.

Për dallim nga Amerika, Rusia pas vitit 1992 është shmangur përkohësisht nga Ballkani, por pas vitit 2005 jemi dëshmitarë të kthimit intensiv të Rusisë në Ballkan, veçanërisht në ato hapësira që nuk janë në NATO dhe BE. Para së gjithash në Serbi e në Mal të Zi. Rusia nuk e fsheh se Ballkani është fushë ku i ka interesat e veta të rëndësishme dhe ku dëshiron sërish të zhvillohet si fuqi e madhe, si partner i barabartë me perëndimin.

Në hapësirën e Evropës Juglindore, gjegjësisht në hapësirën e Ballkanit, nuk ka shtet që do të kishte mundësi dhe ambicie të realizueshme për t'u paraqitur si faktor udhëheqës në rajon, apo që do të kishte rëndësi të madhe për interesat strategjike të fuqive të mëdha. Ballkani me ndarjen e tij karakteristike, i ngarkuar me probleme dhe kundërthënie dhe me prapambeturi, është pjesë e Evropës, pa kurrfarë perspektive. E ardhmja e Ballkanit është në BE dhe në NATO.

# Tranzicioni i FSK-së është sukses i përbashkët



Burim RAMADANI

Tranzicioni i FSK-së do të përmbyllet me sukses!

Pa asnjë dilemë! Skepticizmi është krejtësisht i pavend!

As nuk ka nisur ad-hoc dhe as nuk përfundon kuturu. Ky proces është i gjatë dhe i mundimshëm, por tejet i saktë dhe i detajuar.

Qytetarët, komunitet, shtetet rajonale dhe partnerët ndërkombëtare e kanë të qartë se ushtria e Kosovës, që do të jetë e plotë sipas planit 10-vjeçar, është një institucion partner për sigurinë e brendshme, rajonale, por edhe më gjerë. Kosova është aleat dhe i përket botës demokratike. Forca e saj e Sigurisë do të jetë krah për krah me NATO-n dhe shtetet partnere në kontributin për paqe dhe siguri. Si institucion i zhvilluar sipas standardeve të NATO-s, tranzicioni i FSK-së do të jetë dobisjellës për rajonin, po ashtu.

Tranzicioni i FSK-së është një e mirë jo vetëm për qytetarët dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë, por do të jetë ndihmuese për qasjen e përbashkët rajonale ndaj sfidave të ndryshme të sigurisë, me të cilat përballet rajoni dhe bota. Ky proces bazohet në plan dhe qasje gjithëpërfshirëse, transparencë të plotë dhe përpjekje të përbashkëta.

Kosova po kthehet gradualisht në kontribuuese për sigurinë, jo vetëm konsumuese e saj. Në botën e sotme dhe sipas koncepteve të Mbrojtjes së Mençur, Kosova do të kontribuojë në rajon dhe më gjerë.

Anëtarësimi në NATO sigurisht dhe pa dilemë është objektiv nacional, politik dhe qytetar.

Kontributi për paqe është suksesi i Kosovës.

Sidoqoftë, gjithçka bazohet në plan pune të qartë, transparent dhe të koordinuar mirë.

Vendimi për tranzicionin e FSK-së e ka një çelës të suksesit: Puna metodike dhe sistematike. Pa ndërprerje, me saktësi, me bashkërendim dhe me detaje.

Thelbi, po se po, është e drejta e Kosovës që të ketë organizatën e vet ushtarake. Krahas kësaj, puna e mirë që është bërë në FSK dhe mbështetja e vazhdueshme e partnerëve strategjikë. Këto nuk diskutohen!

Gjatë këtyre tetë (8) muajve që jam në detyrë dhe angazhohem në koordinimin e dokumentimit dhe kampanjën informuese mbi FSK-në, gjithçka ka qenë e qartë. Ama, bash e qartë.

Secili muaj dhe secila javë e punës ka qenë e planifikuar në këtë proces, që ka qenë dhe mbetet prioriteti kryesor.

Metodologjia e punës e thjeshtë, shkollore dhe e qartë: Dokumentimi i të gjitha të arriturave jo vetëm në FSK, por në të gjitha institucionet e Kosovës. Theksi, sigurisht, në argumentimin se Kosova ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të ndërtuar shoqëri gjithëpërfshirëse, institucione demokratike dhe multietnike, si dhe FSK-ja ka arritur shkallë të kthehet në institucion profesional e multietnik, i krahasueshëm me vendet e NATO-s.

Me dhjetëra ditë janë kaluar në ndërtimin e narrativit dokumentues dhe argumentues. Me dhjetëra ditë, pastaj, janë kaluar në shpërndarjen dhe koordinimin e këtij narrativi me partnerët strategjikë.

Asnjëherë dhe në asnjë sekondë të vetëm ky proces dokumentimi e argumentimi nuk është trajtuar si lojë. Sepse, nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë lojë. Është thelbi i procesit. Është themeli i ecjes më tutje. Kështu, kemi arritur deri te formulimet finale të dokumentimit dhe argumentimit.

Me shumë institucione të Kosovës, pastaj, janë ndarë këto. Nuk kam hezituar asnjëherë që t'i trokas në zyre secilit institucion relevant në Kosovë për të ndarë me përgjegjësit këtë dokumentim.

Më tutje, ka filluar faza tjetër, tejet e rëndësishme dhe vendimtare: ajo e kampanjës informuese jashtë Kosovës. Kulmi i saj ka qenë kampanja informuese në selinë qendrore të NATO-s. Dhe, kampanja e tillë nuk duhet të përfundojë këtu.

Kosova, thjeshtë dhe qartë, ka agjendë integruese për në familjen euro-atlantike. Nuk ka asgjë të fshehtë në këtë rrugë. Është kontribuuese dhe assesi kërcënuese.

Kosova është e gatshme të punojë krah për krah me shtetet e rajonit (me të gjitha!) për t'u përballur me sfidat e përbashkëta të sigurisë rajonale e globale.

**(Autori është zëvendësministër i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës - MFSK)**

## ShBA-ja, 20 milionë dollarë Meksikës për të deportuar emigrantët



UASHINGTON, 14 SHTATOR- Administrata amerikane duket e gatshme të paguajë miliona dollarë, për të ndihmuar Meksikën të deportojë mijëra emigrantë që kanë hyrë në vend me shpresën për të mbërritur një ditë në Shtetet e Bashkuara.

Sipas një njoftimi të zyrtarëve të Departamentit amerikan të Shtetit, dërguar Kongresit, shuma prej 20 milionë dollarësh mund të përdoret për të mbuluar kostot e autobusëve apo biletave të avionit për të deportuar emigrantët nga Meksika drejt vendeve të tyre të origjinës. Fondet do të transferohen nga DASH-i drejt Departamentit të Sigurisë së Brendshme, si pjesë e një programi pilot për "largimin e emigrantëve", gjë që mund të rezultojë në deportimin e rreth 17 mijë personave nga Meksika.

# Uragani 'Florence' prek tokën në Karolinën e Veriut, 80 mijë persona mbesin pa energji elektrike

Stuhia e fuqishme "Florence" ka arritur afër bregdetit të Karolinës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çka ka rezultuar me vërshime dhe mungesë të energjisë elektrike për gati 80,000 persona



NEW BERN, 14 SHTATOR- Të paktën 150 persona janë bllokuar në qytetin New Bern të Karolinës së Veriut, për shkak të rritjes së nivelit të ujërave në një kohë kur epiqendra e uraganit "Florence" ka prekur tashmë bregdetin lindor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ekipe shpëtimi ka ende në zonat e parashikuara të trajektores së tij.

Sipas një zëdhënëseje të Bashkisë së qytetit, sasia e ujit që vjen prej dallgëve të larta vazhdon të rritet teksa "Florence" kalon përgjatë zonës ku deri më tani janë shpëtuar të paktën 200 vetë.

Qendra Kombëtare e Uraganëve ka njoftuar se lumi Neuse pranë qytetit ka regjistruar më shumë se tri metra rritje të nivelit të tij, duke shkaktuar përmbytje të zonave përreth.

Zyrtarë lokalë kishin paralajmëruar njerëzit "të ngjiteshin në katet më të larta të godinave të banimit", edhe pse u kanë siguruar atyre se do të shkojnë t'i ndihmojnë për çdo rast.

Uragani "Florence" pushtoi rrugët buzë detit dhe la dhjetëra mijëra shtëpi pa energji elektrike.

Erërat e furishme rrëzuan pemë në tokë, ndërsa zona të tëra mbetën në ujë si pasojë e reshjeve të dendura por edhe ujit të ardhur nga deti.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka thënë përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" se zyrtarët e emergjencës dhe ata të ndihmës së parë janë "të furnizuar dhe të gatshëm". Banorët e pjesës më të madhe të Karolinës janë evakuuar, shkollat dhe bizneset janë mbyllur, si dhe rreth 1,500 fluturime janë anuluar.

# Vuçiqi: Marrëveshja me Kosovën duhet t'i garantojë Serbisë anëtarësim në BE



BEOGRAD, 14 SHTATOR- Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se çdo marrëveshje me Kosovën, për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes dy vendeve, duhet t'i garantojë vendit të tij anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Nëse ndonjëherë arrijmë marrëveshje me Kosovën, Serbia duhet ta ketë të sigurt se do të bëhet anëtare e BE-së më 2025", ka thënë Vuçiq në një intervistë për agjencinë e lajmeve "Reuters" më 13 shtator.

Bashkimi Evropian ka thënë disa herë se normalizimi i marrëdhënieve bilaterale në mes të dy shteteve, është element kyç për t'u bërë pjesë e bllokut evropian.

Presidenti serb ka thënë ndër të tjera se arritja e marrëveshjes mund të zgjasë deri në 10 vjet, për shkak të dallimeve mes palëve. "Ndonjëherë qeshi kur dëgjoj njerëzit si i bëjnë gjërat të lehta dhe thonë se, unë do t'ju jap juve tri fshatra dhe unë do t'iu jap gjashtë të tjerë në këmbim", është shprehur ai.

Me këtë deklaratë ai u është referuar diskutimeve të fundit për ndryshim kufijsh në mes të dy shteteve. "Nëse ndonjëherë do të arrijmë marrëveshje, do të ishte një pakt që nuk do të përfshijë vetëm marrëdhëniet në mes neve dhe shqiptarëve në Kosovë, por edhe rezolutën për rrugën drejt BE-së dhe zhvillimin e ardhshëm ekonomik", ka thënë ai. "Tani për tani, ne nuk e dimë ku i kemi kufijtë", është shprehur Vuçiq.

Sipas tij, askush në rajon nuk duhet të jetë i frikësuar nga arritja e ndonjë marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Rajoni do të jetë më stabil, më i fuqishëm dhe më atraktiv", është shprehur ai.

Bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, synojnë arritjen e një marrëveshjeje ligjërisht obliguese për të dyja palët.

Takimi i fundit në mes të dy presidentëve në Bruksel, atij të Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologut të tij serb, Aleksandar Vuçiq, ka dështuar të mbahet, pasi ky i fundit ka refuzuar të takojë delegacionin nga Kosova.

## Hapet zyra e parë ndërlidhëse mes dy Koreve



PENIAN, 14 SHTATOR- Koreja e Veriut dhe ajo e Jugut hapën zyrën e parë ndërlidhëse afër kufirit mes dy vendeve, me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve mes tyre, ka raportuar "Reuters".

Ky vendim është marrë vetëm një javë para mbajtjes së samitit të planifikuar mes udhëheqësve të të dy Koreve në Penian.

Zyra e hapur në zonën kufitare, Kaesong, të Koresë së Veriut përbën vetëm një nga disa hapat e marrë mes dy vendeve, me synim arritjen e pajtimit. Kjo zyrë është e para e llojit të saj, prej kur dy Koretë janë ndarë në fund të Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945.

Deri më tani, dy Koretë kanë përdorur telefonin dhe komunikimet e modelit të faksit, kur kanë planifikuar takime apo kanë ndarë informacione.

Mirëpo edhe këto kanale, shpesh janë pezulluar për shkak të tensioneve të lidhura me programin bërthamor të Koresë së Veriut.

# Nehat Islami, doajen i gazetarisë shqiptare

Tefik SELIMI


Nehat Islami, doajen i gazetarisë shqiptare

Nuk ka gazetar në Kosovë e vende të tjera që nuk e njohin apo që nuk kanë dëgjuar për Nehat Islamin, doajenin e gazetarisë shqiptare. Edhe ata gazetarë që kanë filluar të punojnë më vonë në profesionin e gazetarisë do të duhej ta njihnin dhe të mësojnë nga ky emër i madh i gazetarisë. Pse jo? Nehat Islami është i tëri njeri dhe doajen i gazetarisë. Ai nuk ka kursyer kohën e punën për të raportuar ngjarje nga ku e pati destinacionin e informimit. Ky njeri është shembull i rrallë i gazetarisë, i cili, nga ky profesion i jetës, kurrë nuk hoqi dorë. Përherë shkroi raporte, shënime, skica, reportazhe, por edhe udhëpërshkrime më të ndryshme nga vendet e largëta të Lindjes së Mesme. Jo vetëm kaq.

Nehat Islami (1943) është i lindur në Ferizaj të Kosovës. Këtu e pati vendlindjen, por jeta e "barti" nëpër shumë furtuna e zjarre të largëta të luftës. Gjimnazin e kreu në Prishtinë (1961), kurse Fakultetin Juridik në Universitetin e Zagrebit (1966). Punën si gazetar e filloi në vitin 1966, sepse qe bursist i gazetës "Rilindja". Pas shkollimit, ai orientohet në gazetari. Gazetarinë e adhuroi tejmase. Edhe në këtë moshë 75-vjeçare, ai është i kthelltë dhe shumë aktiv. Ai punoi si korrespondent për gazetën "Rilindja", ku ka raportuar për Lindjen e Mesme e për vendet e tjera të botës.

Pas një viti, Nehati kaloi në redaksinë Televizive të Kosovës, në të cilin vend punoi deri në vitin 1974. Në gazetën "Rilindja" është emëruar si korrespodent për në Lindjen e Mesme me seli në Bejrut, në të cilin vend qëndroi deri në vitin 1979.

Mandej, prej Bejrutit, ai kthehet në gazetën "Rilindja" në postin e redaktorit të politikës së jashtme. Po ashtu, në vitin 1999 ka qenë drejtor i Institutit për Monitorim të Luftës dhe Paqes (IWPR) për tre vjet, kurse që prej vitit 2005 është drejtor i Zyrës së Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës, ku edhe sot gjendet në krye të zyrës në fjalë.

Nehat Islami është njëri nga doajenët e shquar të gazetarisë. Ai bëri përvojë dhe, këtë përvojë pune dëshiron edhe sot ta përcjellë tek kolegët e rinj të gazetarisë.

Ai shton se, gazetarët duhen të raportojnë nga vendi i ngjarjes dhe jo t'i marrin informacionet nga interneti apo mjete tjera jo të sigurta të informimit. Mësojmë se, Nehat Islami, doajeni i gazetarisë sonë, punoi 12 vjet si reporter nga Lindja e Mesme gjatë viteve 1970. Pra, Nehat Islami, gjerë më tani ka shkruar mbi 200 reportazhe, filma dokumentarë televizivë, por është autor i mijërave shkrimeve gazetareske që flasin për Kosovën dhe botën.

Ka shkruar librin me titull "Hotel Bejruti", në të cilin i ka të përmbledhur të gjitha reportazhet gjatë periudhës katërvjeçare në Libani, Siria, po ashtu ka reportazhe që flasin për luftën irako-iraniane. Në këtë libër ka edhe "sende" të marrëveshjeve historike që janë bërë në vitin 1977 midis Egjiptit dhe Izraelit, atëherë kur Sadati shkoi në Izrael dhe shtriu dorën e pajtimit.

Por, ajo që na intereson është fakti se, ai ka shkruar edhe për problemin palestinez, por dhe për prezencën e shqiptarëve në këtë pjesë të botës. Ka shkruar gjithashtu për veprimtarinë e Pashko Vasës, një shkrimtar dhe poet i njohur me poezinë "O moj Shqipëri e mjera Shqipëri". Ka shkruar për historinë 150-vjeçare të dinastisë shqiptare të Mehmet Ali Pashës në Egjipt, i cili e krijoi shtetin modern të Egjiptit.

Edhe pas kësaj pune shumëvjeçare, Nehat Islami, gazetari ynë i shquar e me përvojë, edhe në këtë moshë 75-vjeçare, ndjehet fort mirë me shëndet. Ai e jeton jetën plot gaz. Është njeri i afërt dhe shumë korrekt. Fytyra e tij rri përherë e buzëqeshur, sepse, njerëzit që punojnë për të mirën e popullit dhe vendit, sikur krenohet dhe ka përse ta ndjejë vetën të tillë.

Ai sot i këshillon gazetarët e shumtë të gazetave e portaleve. Thotë se, duhet të respektohet kodi i gazetarisë. Sepse, gazetaria ka një "ligj", i cili duhet të respektohet gjer në fund. Pa këtë ligj, nuk ka etikë gazetarie. Unë jam për respektim të kësaj etike të gazetarisë.

"Sot, sipas Nehat Islamit, gazetar shumëvjeçar, gazetaria e sotme ka ndryshuar shumë. Nuk ka më gazeta që gazetari raporton me pak informacione. Informacionet e bëjnë gazetarinë e qëndrueshme. Sa më shumë informacione, aq më i fortë është shkrimi, lajmi, apo informata. Tash jeta është bërë shumëdinamike, ku gazetat dhe portalet janë media shumë të shpejta dhe kërkojnë shpejtësi e përgjegjësi. Kjo duhet të respektohet. Nuk ka më mirë se të shkruash me argumente dhe fakte. Këto janë "sende" që qëndrojnë dhe japin kuptim jetës", ka shtuar Nehat Islami, gazetar me përvojë, në një debat të organizuar ditë më parë në Gjilan.




# Sot mbahet Festivali i Valleve për Fëmijë 'Ylberi i Prishtinës' 2018

**Prishtinë, 14 shtator**- Sot (e shtunë) mbahet Festivali i Valleve për Fëmijë "Ylberi i Prishtinës" 2018. Defileu i ansambleve fillon në orën 17:00 nga Sheshi "Adem Jashari" (plateja te komuna e vjetër) për të vazhduar përgjatë Sheshit "Ibrahim Rugova", "Skënderbeu", "Nëna Terezë" e deri te Sheshi "Zahir Pajaziti".

Ceremonia e hapjes së festivalit do të bëhet në orën 18:00 në amfiteatrin e hapur në Sheshin "Zahir Pajaziti".

Festivali Tradicional i Valleve për Fëmijë "Ylberi i Prishtinës" 2018 organizohet për të gjashtëmbëdhjetin vit me radhë dhe është një ndër ngjarjet më të rëndësishme kulturore për fëmijë që zhvillohet në Prishtinë.

Festivali organizohet nga Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Kulturë dhe realizohet nga Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës.

E rrallë

# Për herë të parë, piktura e një artisti të gjallë arrin vlerën 80 milionë dollarë



Piktura e britanikut David Hockney do jetë puna më e shtrenjtë e shitur ndonjëherë në ankand nga një artist që jeton. Portreti i (Pool with Two Figures) pritet të shitet për 80 milionë dollarë në Nju Jork në nëntor, sipas kompanisë së ankandit Christie's. "Është një nga kryeveprat e mëdha të epokës moderne", ka thënë Christie. Rekordi aktual i takon amerikanit Jeff Koons. Skulptura e tij prej çeliku u shit për 58 milionë dollarë në vitin 2013.

FOTO E DITES



Një këlysh i bardhë shihet në një kopsht zoologjik në qytetin e dytë më të madh të Bangladeshit, Chittagong /AFP/

E jashtëzakonshme

# Ndodh në Nju Jork, në certifikatë shënohet 'gjinia x'




"Gender X": ky shënim që nga tani e tutje do mund të shfaqet në certifikatën e lindjes në Nju Jork është për të treguar gjininë e papërcaktuar të personit që e ka. Vendimi u mor me shumicë votash nga Këshilli i Shtetit dhe do u lejojë edhe prindërve të zgjedhin gjininë X për profilet e bijve të tyre të sapolindur.

## BARSOLETA E DITËS



**Gjyqtari pyet të dëmtuarin:**
**- Thoni se i akuzuari ju qëlloi me kovë në kokë?**
**- Mu në mes.**
**- Po në kokën tuaj nuk vërehet asgjë.**
**- Ndoshta, por shikojeni kovën si është bërë!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të bëni dhurata për njerëzit e dashur ose për kolegët. Është dita kur ndiheni mjaft mirë dhe doni ta përçoni këtë pozitivitet.



**DEMI**
Karriera është ajo që ju shqetëson sot dhe e keni primare në ditën tuaj. Disa lëvizje në ambientin e punës kanë rritur ambiciet tuaja personale.



**BINJAKËT**
Sot jeni me fat si në lojë ashtu edhe në dashuri. Mund të provoni fatin pa pasur merakun nëse do të fitoni ose jo. Yjet janë në anën tuaj.



**GAFORRJA**
Do të dëgjoni xhelozitë e partnerit përgjatë gjithë ditës sot. Nëse një person i caktuar ka ridalë përsëri nga e kaluara, ka krijuar problem në lidhjen tuaj.



**LUANI**
Sot jeni si koha, të plogësht dhe disi gri. Nuk ju pëlqen të lëvizni dhe të kryeni asnjë aktivitet. Ju ka pllakosur gjendja indiferente dhe rutina.



**VIRGJERESHA**
Ju pëlqen të lexoni në këtë periudhe dhe po i kushtoni shumë kohë blerjes së librave dhe këshillave për tituj interesantë.



**PESHORJA**
Indiferenca është arma më e mirë me disa persona të caktuar. Kështu nuk do të mund t'ju bezdisin dhe shqetësojnë me fjalët e tyre.



**AKREPI**
Edhe pse po mundoheni të tregoheni autoritare në një ambient të caktuar nuk jeni tipat e duhur. Do t'i mblidhni të gjithë për një gotë verë me pas.



**SHIGJETARI**
Ka persona që ikin dhe ka persona të rinj që hyjnë në jetën tuaj. Raportet njerëzore janë të ndërtuara kështu dhe s'mund t'i shpëtoni as ju.



**BRICJAPI**
Sot jeni në harmoni të plotë me partnerin dhe çdo dëshirë e juaja do të bëhet realitet. Kishit kohë që nuk ishit ndjerë kështu.



**UJORI**
Një takim i rastësishëm sot do të kthehet në një miqësi të mirë pas pak kohësh. Do ta kujtoni me nostalgji këtë moment me vonë.



**PESHQIT**
Sot e rëndësishme është të kapni thelbin e gjërave pa u hapur shumë nëpër detaje që mund t'ju ç'organizojnë ditën. Zgjidhni gjerat që doni të bëni.

# Scooter Braun frikësohej se Justin Bieber do të vdiste nga mbidoza



Scooter Braun mendoi se Justin Bieber do të binte në overdozë dhe do të vdiste në kohën kur artisti ishte në një 'periudhë të errët', gjatë viteve të fundit. "Ishte një kohë kur unë nuk doja të flija, sepse ai kishte para për të ikur nga unë dhe shqetësohesha çdo natë se mund ta humbisja atë. Ai donte të udhëtonte, por unë mendoja që nëse e bën këtë, do të vdiste. Kështu që unë vetëm e refuzoja. Ne nuk po bënim para, nuk doja të përfitoja, nuk doja që ai të punonte, doja që ai të shërohej", ka thënë Braun për Van Lathan, gjatë kësaj jave.

# Sofia Vergara: S'ishte e lehtë të bëhesha aktorja më e paguar në televizion






Sofia Vergara mund të jetë aktorja më e paguar në televizion por nuk ishte e lehtë të arrinte këtu. "Është diçka që më është shpërblyer. Unë jam 46-vjeçare dhe kam punuar për gati 30 vjet. Pra, të jesh në gjendje të bësh diçka që do në botën e shoubizit, dhe mbi të gjitha të jesh në gjendje të bësh para? Ishte një eksperiencë e mrekullueshme por nuk ishte e lehtë", ka thënë ylli i "Modern Family" për revistën Health të muajit tetor.



# Irina Shayk mbetet një nga femrat më të bukura në botë



Irina Shayk pa dyshim që është një nga femrat më të bukura në botë. Supermodelja ruse e ka dëshmuar tashmë që në çdo paraqitje të sajën, fiton vëmendje, por shpesh ajo di të jetë dhe sensuale e joshëse. 32-vjeçarja së fundmi vjen me një fotografi, ku shfaqet në një fustan të kuq, e ku shfaq edhe pjesën intime, ku duket madje pa të brendshme. Irina tashmë është nënë e një vajze nga bashkëjetesa me aktorin hollivudian, Bradley Cooper.

# Kur do të rikthehet Rihanna?



Këngëtarja e famshme botërore, Rihanna, nuk ka hedhur në treg asnjë hit të ri që prej vitit 2016, por ajo i ka siguruar fansat se po punon për materiale të reja. 30-vjeçarja ka sqaruar se gjatë kësaj kohe ka qenë e zënë duke u fokusuar në linjën e saj kozmetike dhe filmin, ndërkohë që ka premtuar se do të hedhë në treg disa këngë të reja në të ardhmen e afërt. Duke iu përgjigjur një ndjekësi në "Instagram", i cili pyeti se ku ishte muzika e saj e re, këngëtarja e "Diamonds" iu përgjigj: "Jam duke bërë muzikë, njëkohësisht duke bërë kozmetikë dhe film", ka thënë ajo.





Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| BRENTFORD - WIGAN | 1 | HULL - IPSWICH | 1 | VALENCIA - BETIS | 1 |
|---|---|---|---|---|---|

# Kryesuesit ndajnë 'mejdanin' në 'Zahir Pajaziti'

Lideri i elitës, Flamurtari, dhe skuadra e dytë në tabelë, Llapi, do të përballen të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti" në derbin e javës së pestë në Superligë. "Ne e kemi kaluar presionin në ndeshjen ndaj Lirisë dhe tash do të luajmë pa ndonjë presion ndaj Llapit. Kundërshtari ynë i radhës e ka skuadrën më cilësore dhe ne do të angazhohemi dhe do të mundohemi të dalim të pamposhtur në këtë ndeshje, çka do të jetë mjaft vështirë për t'u arritur", ka thënë Thaqi për "Epokën e re"



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Xhiro e pestë e IPKO Superligës së Kosovës në futboll do të sjellë dy derbi. Të shtunën Feronikeli do të luajë ndaj kampiones aktuale, Dritës, kurse të dielën Llapi e pret skuadrën lidere, Flamurtarin. Trajneri i skuadrës kuqezi, Arsim Thaqi, ndihet krenar me rezultatet e arritura nga skuadra e tij në këtë kampionat, por edhe në ndeshjen ndaj Llapit dëshiron të marrë rezultat pozitiv. "Ne e kemi kaluar presionin në ndeshjen ndaj Lirisë dhe tash do të luajmë pa ndonjë presion ndaj Llapit. Kundërshtari ynë i radhës e ka skuadrën më cilësore dhe ne do të angazhohemi dhe do të mundohemi të dalim të pamposhtur në këtë ndeshje, çfarë do të jetë mjaft vështirë për tu arritur", ka thënë Thaqi për "Epokën e re". Strategu Thaqi në të kaluarën ka punuar me kundërshtarin e radhës, Bylbyl Sokolin. Ai lidhur me këtë përballje ka deklaruar: "Kemi punuar me Sokolin një kohë të gjatë, por emocionet e përballjes i kam kaluar për faktin se jemi përballur edhe më herët".

Për ndeshjen e së dielës ka folur për gazetë edhe Bylbyl Sokoli, i cili me Llapin zë vendin e dytë në tabelë. "Profa" e ka lavdëruar skuadrën e Flamurtarit, por lë të nënkuptohet se Llapi synon maksimumin e pikëve. "Flamurtari ka një kryesi, trajner dhe skuadër të mirë, prandaj nuk është rastësisht në pozitën e parë. Ne do ta analizojmë këtë ndeshje derbi dhe do të përpiqemi, me angazhimin e të gjithëve, të marrim rezultat pozitiv. Besojmë se do të kemi vazhdimësi të rezultateve, por këto mund të arrihen vetëm me një angazhim të përbashkët", ka deklaruar Sokoli.

**IPKO SUPERLIGA**

15:45 Gjilani - Ballkani
15:45 Feronikeli - Drita
19:45 Prishtina - Ferizaj

Të dielën takohen:
15:45 Liria - KEK-u
15:45 Llapi - Flamurtari
15:45 Trepça '89 - Drenica

## SHKURT

### KB Prishtina transferon Divine Mylesin

Divine Myles është transferimi i fundit i skuadrës së Prishtinës në basketboll. "Myles luan në pozitën e fundorit dhe do të jetë ndihmesë e madhe gjatë rrugëtimit tonë si në garat e FIBA-s, po ashtu në garat vendore. Mylesi karakterizohet me lojë të gjithanshme në të gjitha repartet. Mylesi është 21-vjeçar, i gjatë 180 cm. Karrierën e filloi dhe e përfundoi tek kolegji Stentson (NCAA). Vitin e fundit të kolegjit e përfundoi me këto statistika: 31 lojë, 16,8 pikë për lojë, 4,5 kërcime për loje, 4,2 asistime për lojë", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

### Munishi largohet nga Besa

Ismet Munishi nuk është më trajner i Besës së Pejës pasi ka vendosur të jap dorëheqje, duke mos treguar arsyet. "Për arsye personale më nuk jam trajner i klubit të madh Besa. Besoj se kryesia, stafi dhe lojtarët do të kenë suksese dhe do të kenë besë sikurse e ka emrin klubi. Besa besë, shumë suksese", ka shkruar Munishi në "Facebook". Klubi pejan në Ligën e Parë ka regjistruar dy fitore dhje një barazim.

### Mavraj prezantohet tek Arisi

Reprezentuesi i Shqipërisë, Mërgim Mavraj, sot është prezantuar nga klubi grek i Arisit të Selanikut. Mavraj do të jetë shok skuadre në klubin grek me mesfushorin e Kombëtares së Shqipërisë, Migjen Basha. Mavraj në të kaluarën ka luajtur për Hamburgun, Kolnin dhe disa skuadra të tjera gjermane.

### Challandesi: Kryeziu është në listën time

Kombëtarja e Zvicrës është duke e monitoruar situatën e Mirlind Kryeziut, por konkurrenca atje është më e madhe. Kosova e do, pasi trajneri Bernard Challandes ka dalë hapur me dëshirën për ta afruar në skuadër. Shqipëria po punon, pavarësisht se duket një alternativë më e largët. Kryeziu ende nuk ka vendosur se për kë do të luajë dhe po pret. Nga krahu tjetër, trajneri i Kosovës, Bernard Challndes, shfaqet diplomat me deklaratën e tij për "Blick" për afrimin e futbollistëve. "Kam folur me presidentin e Federatës së Zvicrës, Peter Gillieron. E kemi gjetur njëri-tjetrin shumë shpejt. Kryeziu (Marlindi) është në listën time, sigurisht… Unë do të mundohem ta bind çdo njeri. Vetëm atëherë kur dikush arrin në përfundimin se nuk do ta provojë me Zvicrën mund të vijë te ne, sigurisht nëse do të luajë për Kosovën, pasi mund të luajë dhe për Shqipërinë. Për mua vlen vetëm një gjë: dëshira e lojtarit", ka thënë Challandes.

## Grezda përkrah Gerrardit: Jam i kënaqur se do të luaj me Rangersin

GLASGOU, 14 SHTATOR - Reprezentuesi i Shqipërisë në futboll, Eros Grezda, ka dalë në konferencën për shtyp përkrah trajnerit Stiven Gerrard. Grezda ndihet shumë i lumtur që do të luajë për skuadrën e Rangersit, kurse debutimi i tij mund të vijë të shtunën në ndeshjen ndaj Dundes. "Stafi me të cilin jam duke punuar është shumë profesional dhe unë po punoj mirë me të. Jam shumë i kënaqur që do të luaj me ekipin e Rangersit dhe futbollistët në këtë klub, po më ndihmojnë shumë në ditët e parë. Kam nevojë për këtë gjë, pasi është diferencë e madhe për mua të vij nga ambient ku kam qenë në Skoci. Nuk jam ende në formën time më të mirë, por po punoj shumë që të kthehem atje. Jam duke punuar shumë me stafin e skuadrës që të përmirësohem akoma më shumë për të qenë i gatshëm si zëvendësues ndaj Dundes", ka thënë Grezda.



## Operohet Westbrooki, 2 muaj pushim

OKLAHOMA, 14 SHTATOR - Basketbollisti i skuadrës së Oklahoma Thunderit, Russell Westbrook, është operuar në gjurin e majtë dhe rrezikon të mos luajë për gati dy muaj. Lajmin e kanë konfirmuar drejtuesit e skuadrës së Thunderit që deklarojnë se gjasat që një nga yjet e NBA-së (MVP i sezonit 2016-2017) të jetë në startin e sezonit të ri janë të pakta. Të paktën katër javë basketbollisti do të qëndrojë pushim absolut dhe më pas do ta nisë fazën e rikuperimit dhe stërvitjes me top, pasi të marrë "OK"-in nga mjekët. Westbrooki nuk do ta zhvillojë fazën përgatitore me skuadrën gjatë këtij muaji, por do t'i bashkohet ekipit vetëm në mesin e muajit tetor, por debutimin sezonal mund ta kryejë në nëntor.



# Sot fillon hendbolli



Prishtinë, 14 shtator - Me derbin në mes të Prishtinës dhe Dritës nis kampionati i ri i Kosovës në hendboll për meshkuj. Pritjet janë për një kampionat cilësor e, mbi të gjitha, me rivalitet të madh në garën për titull. Organizimi i një pjese të mirë të klubeve gjatë verës bënë që fillimi i edicionit 2018\19 të pritet me optimizëm të theksuar. Në garë për kreun e tabelës, pos kampionit aktual, Besa Famgas, pritet të përfshihen edhe klube të tjera si Kastrioti, Prishtina, Drita e ndonjë tjetër. Ka pasur mjaft lëvizje të lojtarëve në afatin kalimtar të verës dhe kjo mund ta bëjë të paparashikueshme garën për titull. Ndeshja në mes të Prishtinës dhe Dritës luhet të shtunën (sot) prej orës 17:30. Të dy skuadrat i kanë nisur me kohë përgatitjet dhe kanë bërë ndryshime të mëdha në përbërje. Se në çfarë gjendje janë këto dy skuadra do të dëshmojë derbi i javës së parë. Gjysmë ore më vonë (18:00) nis takimi në mes të Trepçës dhe kampiones aktuale, Besa Famgas. Besa është favorite e madhe pasi ka mbajtur fondin e lojtarëve vendorë dhe ka dy muaj që ka nisur përgatitjet. Fundjavën e kaluar Besa shënoi dy fitore në kuadër të Kupës së EHF-së ndaj ekipit gjeorgjian Batumi. Trepça këtë edicion e nis kryesisht me fond të lojtarëve të rinj dhe pa pretendime shumë të mëdha. Të shtunën luhet edhe takimi në mes të Drenicës dhe Vushtrrisë, që nis në ora 19:00. Drenica kthehet në elitë me shpresë për të mbetur gjatë në të dhe, po ashtu, të ketë plasman të mirë. Edhe Vushtrria i ka pretendimet e saj. Dy ndeshje të javës së parë luhen të dielën. Nga ora 18:00 takohen Samadrexha dhe Kastrioti. Ferizajasit kanë bërë përforcime të shumta për këtë edicion dhe llogariten favoritë. Në orën 18:00 nis edhe takimi mes Vëllaznimit dhe Zhegrës.

# Ceferin: Finalja e Ligës së Kampionëve nuk luhet jashtë Evropës



Nju Jork, 14 shtator - Spekulimet që edhe Liga e Kampionëve mund të bartet për ta zhvilluar finalen në ShBA i ka mohuar numri një i UEFA-s. Aleksandër Ceferin ka vendosur të mos ketë një finale të Ligës së Kampionëve në Nju Jork siç është përfolur ditët e fundit. "Kjo ide nuk është diskutuar asnjëherë zyrtarisht", ka theksuar presidenti i UEFA-s nëpërmjet një komunikate për shtyp. "Ne nuk kemi ndërmend të zhvillojmë një finale të Ligës së Kampionëve jashtë kontinentit evropian", ka shtuar ai më pas.
Një nga përfaqësuesit e "Mediapro", kompanisë që ka të drejtat televizive të Ligës së Kampionëve dhe të Ligës së Evropës për Spanjën, ka bërë publik një diskutim të tillë që, me sa duket, u hodh poshtë menjëherë nga 50-vjeçari, numri një i futbollit evropian Ceferin. Pak javë më parë drejtues të kampionatit spanjoll kanë hedhur idenë e zhvillimit të disa ndeshjeve të kampionatit të tyre në ShBA, një temë e diskutueshme dhe e kundërshtuar nga disa klube.

## SHKURT

### De Bruyne, më i shtrenjtë se Neymari

Kevin De Bruyne nuk është në shitje dhe klauzola e tij e lirimit është prej 250 milionë eurosh (më e shtrenjtë se transferimi rekord prej 222 milionë eurosh i Neymarit nga Barcelona te PSG-ja). Këtë lajm e ka konfirmuar trajneri Pep Guardiola. "Ai është shumë i mirë, është lojtar shumë dinamik. Klauzola e lirimit kap shumën e 250 milionë eurove. Më vjen keq, por ai nuk është në shitje", ka thënë Guardiola.

### Pirlo: Pogba mund të rikthehet te Juve

